




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government



Për:	Mytaher Haskuka, Kryetar i Komunës së Prizrenit Sulltan Badalli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prizrenit
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Sekretari i Përgjithshëm i MF-së
Përmes:	
Nga:	Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MPL
Zyrtarët përgjegjës:	Venera Çerkini Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Leonora Bajrami, Zyrtare për monitorim të komunave
Lënda:	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Prizrenit
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Ministria e Pushtetit Lokal, ka pranuar: **Vendimin për caktimin e normave tatimore për tatimin ne pronën e paluajtshme për vitin 2021**, miratuar nga Kuvendi i Komunës së Prizrenit, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Prizrenit me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në Ministrinë e Financave si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni raportin e vlerësimit të Ministrisë së Financave.

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
 Qeveria - Vlada / Government of Kosovo
 Ministria e Financave / Ministry of Finance
 Arkiva - Arhiva - Archive

0129-1/2021
 08.01.2021
 PRISHTINE/A



HYRES-DLAZINA-INCOMING
 REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA / GOVERNMENT OF KOSOVO
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministry of Local Government Administration

Data: 08.01.2021
 -41-020-900/9

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave - Ministarsvo za Finansije
Ministry of Finance

Për:	Goran Rakić, Ministër i Pushtetit Lokal Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, MPL
Kopje:	Kryetari i Komunës së Prizrenit Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL
Përmes:	Agim Krasniqi, Zv. Ministër i Ministrisë së Financave Enis Spahiu, Zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave
Ngat:	Bahrije Berisha, Zv. Drejtoreshë e Departamentit Ligjor, Ministria e Financave
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zytari i vlerësimit ligjor: Shkumbiu Elshani, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave 2. Zytari hartues i vlerësimit ligjor: [Signature]
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërtisë së aktit të Komunës së Prizrenit
Lloji i aktit:	Vendimi i Kuvendit të Komunës



I nderuar Ministër, z. Rakić,
 I nderuara Sekretare e Përgjithshme, znj. Ukimeraj,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 06/2020 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) - NR. 07/2020, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021.

I miratuar me datë: 19.11.2020.

I parashtruar për shqyrtim në MPI me datë: 23.11.2020.

I dërguar për shqyrtim në MI me datë: 25.11.2020.

Në shqyrtimin e përmbajtjesor të aktit, Ministria e Financave vlerëson se caktimi i normave tatimore është kompetencë e komunës në përputhje me *Nenin 9 (Normat Tatimore) të Ligjit Nr. 06 L-005 Tatimit në Pronë*, andaj Vendimi i Kuvendit të Komunës së Prizrenit është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe prodhon efekt juridik.

Me respekt!



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Poshitëtit Lokal
 Ministarstvo Lokalne Samouprave
 Ministry of Local Government

QK/M 19/2020
 23.11.2020

Për	Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave	
Kopje	Kryetar i Komunës së Prizrenit Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL Goran Rakić, Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MPL-së	
Komitet	Veneta Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit të Lajjor dhe Monitorimit të Komunave	
Njësi		Date: 23.11.2020 Nr. 020/992
Zyrtarët përgjegjës	1. Zyrtari përgjegjës: Xhevat Jafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorimin e për përcaktimin e aktit të Komunave në Ministrinë e Lajjor 2. Zyrtari përgjegjës i caktuar Bajrami, Zyrtarë për Monitorimin të Komunave në Institutin shkencës për përcaktimin të aktit.	
Kërkesë për shqyrtim të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Prizrenit	Kërkesë për shqyrtim të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Prizrenit	
Objektivi	Vendim	

Udhëzuar Sekretar,

Ministria e Poshitëtit Lokal, ka pranuar: Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021, i nënshkruar nga kryesia e kuvendit të komunës së Prizrenit, me qallim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Aktive të Komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtim të ligjshmërisë, aktin e komunës së Prizrenit.

Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021.

I miratuar më datë: 19.11.2020
 I parashtruar për shqyrtim në MPL, më datë: 23.11.2020

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Kosovo Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit

Opština Prizren - Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 12, paragrafit 1 dhe 2 pika d), nenit 24 dhe nenit 40 paragrafi 1 dhe 2 pika e), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 9 të Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, nenit 25 paragrafit 1 pika a) dhe h), nenit 27 paragrafit 1, dhe nenit 72 paragrafi 1 pika 6 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Nr. 01/011-5643, dt. 15 tetor 2018. Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më 19 nëntor 2020, ka miratuar:

VENDIM

Për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021.

Neni 1

Normat Tatimore

Në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9 paragrafi 1.1 deri 1.9, Kuvendi Komunal i Komunës së Prizrenit cakton normat tatimore për vitin 2021 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike si vijon:

- Për njësitë bujqësore të parcelave: (0.15%)
- Për njësitë bujqësore të objekteve: (0.15%)
- Për njësitë pyjore të parcelave: (0.15%)
- Për njësitë rezidenciale të parcelave: (0.15%)
- Për njësitë rezidenciale të objekteve: (0.15%)
- Për njësitë komerciale të parcelave: (0.15%)
- Për njësitë komerciale të objekteve: (0.16%)
- Për njësitë industriale të parcelave: (0.15%)
- Për njësitë industriale të objekteve: (0.15%)

Neni 2

Zbatimi

Për zbatimin e kësaj vendimi obligohet Drejtoria për Ekonomi e Financa dhe Zyra e Tatimit në Prizren.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky Vendim, hyn në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform neniit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës. Do të fillojë së zbatuari nga 1 janari 2021.

KOMUNA E PRIZRENIT

Kuvendi i Komunës

Nr. 001/011-126213

Më: 19 nëntor 2020

Prizren

Kryesuesi i Kuvendit
Sulfiq Mustafa